



KKDM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 108 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 26/07 2023

**VENDIM**

Nr.25, date 26 /07/2023

**PËR**

**AKTIN E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT PËR INSTALIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NE DIGEN E QYRSAQIT QE SHFRYTEZOHET NGA KESH**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 24, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 26.07.2023 mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga KESH në lidhje me procesin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për Instalimin e Impiantit Fotovoltaik në digën e Qyrfaqit të HEC Vau I Dejes që shfrytëzohet nga KESH sh.a.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur u vërejt se në dokumentacionin e paraqitur nuk jepen licencat e grupit që ka kryer aktin e kolaudimit si dhe informacion në lidhje me ekonomistin dhe juristin që duhet të jetë në këtë grup sipas kërkesave të nenit 24 të VKM se mesiperme. Gjithashtu, rezultoi se nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 24, pika 2 të VKM se mesiperme në lidhje me njoftimin që duhet të bëhet tek KKDM për perfundimin e punimeve.

Gjate mbledhjes u diskutua në lidhje me mungesat dhe problematikat e konstatuara gjate procesit të kolaudimit të punimeve duke ju referuar legjislacionit në fuqi. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Duke u bazuar në VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, neni 24, ti kërkoj KESH sh.a plotësimin e disa kërkesave në lidhje me procesin e kolaudimit të punimeve ndertimore si me poshte:
  - Kryerjen e Kolaudimit të punimeve të zbatimit për projektin ndertimor të instalimit të impiantit fotovoltaik në digën e Qyrfaqit të HEC Vau I Dejes sipas kërkesave të nenit 24 të VKM Nr. 147, dt. 18.03.2004 brenda muajit Shtator 2023
  - Te njoftoj KKDM sipas VKM se mesiperme brenda muajit Gusht 2023 për kryerjen e Kolaudimit të punimeve të zbatimit për projektin ndertimor të instalimit të Impiantit fotovoltaik në digën e Qyrfaqit
  - Te paraqesë dokumentacionin e plotë të Aktit të kolaudimit për punimet e zbatimit të projektit ndertimor të instalimit të Impiantit fotovoltaik në digën e Qyrfaqit të kryer sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të mesiperme për miratim në KKDM brenda muajit Tetor 2023. Akti i kolaudimit për punimet ndertimore duhet të kryhet nga një grup kolaudimi me licence në fushën e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve në digat e mëdha. Në përberje të grupit duhet të marrin pjesë edhe Ekonomistë dhe Juristë si dhe përfaqësues të KKDM sipas kërkesave të nenit 24 të VKM Nr. 147.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 2- Ti kerkoj KESH sha, monitorimin e kushteve te reja te krijuar ne anen e poshtme te diges se Qyrsaqit duke perfshire matjet e duhura te temperatures ne te pakten 5 vende ku eshte instaluar Impianti sipas nje skeme te percaktuar nga specialistet e monitorimit. Keto temperatura duhet te maten ne pjesen poshte dhe siper paneleve fotovoltaik te instaluar, ne kuroren e diges dhe ne zonen poshte diges me nje frekuence ditore per nje periudhe prej 2 vitesh. Rezultatet e matjeve te kerkuara me siper per periudhen Korrik -Dhjetor 2023, te shoqeruar me grafiket dhe konkluzionet perkatese duhet te jene pjese e Raportit vjetor te KESH sh.a per vitin 2023 e ne vijim
- 3- Ti kerkoj KESH sh.a qe te Hartoj dhe te dorezoj brenda muajit Tetor 2023 te Rregullores se shfrytezimit, mirembajtjes, monitorimit dhe Sigurise se diges se Qyrsaqit duke perfshire edhe rregulloren perkatese per shfrytezimin dhe monitorimin e impiantit fotovoltaik te instaluar

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM per ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

